

# **ANALIZË STATISTIKORE E TREGUESVE TË INSPEKTIMIT**

Informacion i përpunuar i të dhënave të inspektimeve të kryera në  
3-mujorin e parë 2019, raportuar nga 12 Degët Rajonale të  
ISHPSHSH-së

**KRYEINSPEKTORI**

**Arben Seferaj**

3-mujori i  
parë 2019

Gjatë 3 mujorit të parë të vitit 2019, Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, ka kontrolluar zbatueshmërinë e Legjislacionit të Punës nëpërmjet inspektimeve të kryera në 3533 aktivitete ekonomike, private e shtetërore. Ose 2.2 here me shume se 3 mujori i pare 2018

Në këto inspektime është ndjekur dhe kontrolluar sigurimi i zbatimit të dispozitave ligjore për 73517 punëmarrës në lidhje me:

- kushtet e punës dhe mbrojtjen në ushtrimin e profesionit të tyre,
- kohëzgjatjen e punës,
- pagat,
- sigurimin shoqëror e shëndetësor,
- higjienën dhe mirëqenien,
- punësimin e fëmijëve, të të miturve dhe grave,
- si dhe për çështje të tjera që lidhen ngushtë me marrëdhënien e punës dhe sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës.

Orientimi i inspektimeve ka qënë:

- Rritja e besueshmërisë, nëpërmjet trajtimit dhe dhënies zgjidhje të ankesave të ardhura nga punëmarrës dhe punëdhënës.
- Minimizimi i punës informale nëpërmjet forcimit të kontrollit, dhe marrjes së masës urgjente “pezullim” për çdo punëmarrës të evidentuar në punë pa siguracion, dhe sigurimin e tij konform legjislacionit, pa të cilin nuk lejohet të vazhdojë punën.
- Orientimi i kontrolleve drejt aktiviteteve ekonomike që paraqesin rrezikshmëri të lartë për siguri e mirëqenie në punë të punëmarrësit
- Monitorimi i vazhdueshëm i punës nga portali ndaj gjithë strukturës inspektuese, duke ofruar mbështetje për kryerjen në mënyrë sa më korrekte të detyrës.
- Rritjen e kujdesit shoqëror komunitar, në respektim të standarteve të reja për këtë tipologji, por edhe rritja e kapaciteteve të pushtetit vendor për ofrimin e këtyre shërbimeve, në përputhje me nevojat e gjithë komunitetit;
- Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të kujdesit shoqëror, garantimi i respektimit të standarteve të shërbimeve, më qëllim respektimin e të drejtave të përfituesit dhe mbrojtjen e tij nga diskriminimi, dhuna, abuzimi, duke vlerësuar prioritet forcimin e mekanizmave, procedurave të mbrojtjes si edhe rritjen e sensibilitetit të komunitetit ndaj procesit të ankimimit.

Inspektimet e kryera në këtë periudhë, janë rezultat i:

Inspektime të planifikuara \_\_\_\_\_3313

Inspektime jashte planifikimi \_\_\_\_\_220


Inspektimet e planifikuara zënë 94% të inspektimeve të realizuara në këtë priudhë, ndërkohë rastet e inspektimeve jashtë palnifikimi rezultojnë:

Inspektime për shkak aksident në punë _____	49
Inspektime për shkak ankese _____	127
Inspektime rastësore _____	44

Inspektimet e realizuara për shkak ankese janë ato që zënë 57.7% të inspektimeve jashtë plani.

Risi në këtë vit, dhe pjesë e punës tonë tashmë janë inspektimet rastësorë të iniciuara për shkelje flagrante të Lëgjislacionit të Punës, e ku tashmë zënë 20% të inspektimeve jo të planifikuara e kun ë të njëjtën periudhë të 2018, ishin të papërfillshme.


Inspektime jashte planifikimi: Janar-Mars 2019



Krahasimisht me një vit më parë në këtë 3-mujor kemi, numër të shtuar të rasteve të inspektimeve për shkak aksidenti në punë si dhe për shkak ankese.

- 13 Inspektime më shumë për aksident në punë
- 31 Inspektime më shumë për shkak ankese
- 42 Inspektime më shumë rastësore

Të dhëna krahasuese të dy periudhave respective 3-mujore:



Ndërkohë nga 3313 subjektet e inspektuara si çështje të programuara janë programuar me tematikat si më poshtë:

Inspektive te programuar ne bazë risku 3105

Riinspektive (zbatueshmerinë e detyrave të lëna) 32 subjekte

Realizuar në turn të dytë ska inspektive

Realizuar në turn të tretë ska inspektive

Realizuar në ditët e pushimeve apo festave zyrtare 6 inspektive

Realizuar pas kërkesës “Për autorizim për të mitur” 5 subjekte

Realizuar pas kërkesës “Për autorizim për kryerje pune mbi kohën normale të punës”  
2 subjekte

Realizuar pas kërkesës “Për autorizim për leje pune” 6 Subjekte

Realizuar në bashkëpunim, Keshillim, te tjera 157 subjekte

Nga inspektimet tematike vlen të përmendim inspektimet e realizuara me njoftim paraprak opsion ky i ndryshuar në kuadër të deregulimit. Kështu nga 5 inspektimet e realizuara për autorizim për të mitur, janë 4 punëmarrës nën 18 vjeç të autorizuar për të punuar pranë këtyre subjekteve.

Nga 2 inspektive të realizuara për miratim pune jashtë kohës normale të punës, përmendim se vetëm për një subjekt është miratuar punë me orë shtesë.

Ndërkohë kërkesa për leje punë gjatë 3-mujorit të parë 2018, janë inspektuar 6 subjekte .

Gjithashtu këto muaj janë realizuar 157 inspektive keshilluese dhe tematike mbi aplikuesit e programit IPARD II 2014-2020. Për aplikuesit pas procedurës së inspektimit u është dorëzuar dhe çertifikata që verteton përpunueshmërinë e subjektit me standartet e BE-së për sigurinë dhe shëndetin në punë, sipas parashikimeve në legjislacionin e BE-së dhe atë shqiptar në lidhje me investimin dhe

me standaret e sigurisë në punë, bazuar në inspektimin e kryer nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore në object.

Më konkretisht në 12 degëve rajonale, inspektimet e kryera gjatë 3-mujorit të parë 2019, sipas tematikës së tyre rezultojnë:

Degët Rajonale	Total Inspektime (Private+Shtetërore)	Inspektime per aksident	Inspektime per ankese	Inspektime rastesore
Berat	141	1	4	-
Dibër	123	7	1	-
Durrës	280	7	12	10
Elbasan	312	4	8	2
Fier	331	1	2	-
Gjirokastrë	66	1	-	2
Korçë	272	3	2	4
Kukes	91	2	-	12
Lezhë	143	4	2	1
Shkodër	251	4	4	-
Tiranë	1,255	15	78	6
Vlorë	268	-	14	7
<b>Total</b>	<b>3533</b>	<b>49</b>	<b>127</b>	<b>44</b>

Të gjitha inspektimet janë inspektime të kryera online përmes portalit “e-inspection”.

Këtu vlen të përmendim faktin se në varësi të çështjes, procedurës dhe kohëzgjatjes së inspektimit, kemi disa diferenca me çështje të punuara përmes portalit dhe ato të raportuara në statistika.

Nisur nga problematikat e raportime në portal theksojmë që kemi 1 inspektim kryer nga inspektorë të Degës Vlore përmes një procedure të rregullt inspektimi, ndërkohë që edhe pse janë procedura tashmë të mbyllura në portal gjatë muajit mars 2019, nuk rezulton si çështje e mbyllur në këtë sistem por çështje në progres. (problematikë kjo e raportuar).

Nga të dhënat e inspektimeve të subjekteve ekonomike (private e shtetërore) raportuar nga degët rajonale të ISHPSHSH-së, në 12 qarqet e vendit, kemi:


Të ndara sipas llojit të aktiviteteve ekonomike të inspektuara kemi:

Aktivitetet ekonomike të inspektuara gjatë këtij muaji, rezultojnë të jenë në masën 44 % ne aktivitete Tregti Hotel Bar, restorante, 24 % inspektime të kryera në aktivitete prodhuese, 17% inspektime të kryera në aktivitete të tjera, 6 % inspektime të kryera në ndërtim, 3 % ne aktivitete bujqësi-pyje-peshkim, 2 % ne miniera karriera, etj.

- Bujqësi, pyje, peshkim 96
- Miniera karriera 58
- Ndërmarrje Prodhuese 840

• Elektricitet, gaz, ujë	40
• Tregti, hotel-bar-restorante	1549
• Ndërtim	223
• Transport, magazinim, telekomunikacion	56
• Finance, shërbime të sigurimeve	53
• Aktivitete të tjera	618

### Inspektime në aktivitetet ekonomike të licensuara, sipas llojit të aktivitetit



### Disa nga treguesit e përgjithshëm statistikorë të inspektimeve realizuar gjatë 3-mujorit të parë 2019, nga trupa inspektuese e ISHPSHSH-së janë:

1- Subjekte të inspektuara Private + Shtetore	_____	3533
2- Vende pune të inspektuara	_____	73517
me mesatarisht Vende pune/subjekt	_____	20.8
3- Subjekte private të inspektuara	_____	3508
4- Vende pune të inspektuara në subjektet private	_____	69511

me mesatarisht Vende pune/subjekt	_____	19.8
5- Punëmarrës pa kontrata individuale të evidentuar	_____	891
6- Punëmarrës informal të evidentuar	_____	297
7- Punëmarrës informal të futur në skemën e SSH	_____	283
Gjate procesit të inspektimit janë siguruar, 95.3 %		
8- Punëmarrës nën 18 vjeç të evidentuar	_____	27
9- Punëmarrës të huaj të evidentuar	_____	191
10- Punëmarrës të huaj, pa leje pune	_____	7
11- Subjekte për të cilët është mbajtur masë urgjente (për marrëdhënie pune)	_____	152
12- Subjekte për të cilët është mbajtur masë urgjente (për siguri në punë)	_____	15
13- Inspektime për shkak Ankese	_____	127
14- Inspektime për shkak Aksidenti	_____	49
15- Punëmarrës të aksidentuar	_____	40
16- Punëmarrës të aksidentuar me vdekje	_____	13
17- Subjekte të sanksionuara	_____	41
18- Vlera totale e sanksioneve	_____	10 064 000 lekë
19- Subjekte me masën “Paralajmërim”	_____	409

**Aktivite private+shtetërore të inspektuara gjatë muajve Janar-Mars 2019**

Degët Rajonale	Inspekti me	Punëmarrës	Femra	P/Pakont rata	P/page minimale	Të huaj	Me aftësi të kufizuar	Nën 18 Vjeç	Informal	U siguruan	P/aksidentuar	vdekje
Berat	141	2184	848	77	1041	41	0	0	4	4	0	0
Diber	123	3605	573	8	249	76	45	0	9	9	8	2
Durrës	280	10806	6444	20	1297	4	0	8	6	6	1	1

Elbasan	312	3304	1229	42	1508	5	5	1	17	16	3	2
Fier	331	4627	1180	4	2006	0	0	0	4	4	1	1
Gjirokastër	66	329	137	79	167	0	0	5	0	0	1	1
Korçë	272	2094	1129	53	1313	1	0	0	29	29	3	1
Kukës	91	687	291	157	389	0	0	0	23	22	2	0
Lezhë	143	3249	1639	75	1939	25	12	4	16	16	4	1
Shkodër	251	4226	2487	54	1928	2	0	3	16	7	4	3
Tiranë	1,255	33379	18466	97	7777	23	8	1	122	121	13	1
Vlorë	268	5027	2690	225	1490	14	0	5	51	49	0	0
<b>Total</b>	<b>3533</b>	<b>73517</b>	<b>37113</b>	<b>891</b>	<b>21104</b>	<b>191</b>	<b>70</b>	<b>27</b>	<b>297</b>	<b>283</b>	<b>40</b>	<b>13</b>

Në lidhje me numrin e dënimeve administrative si “Pezullim për shkelje flagrante të marrëdhënieve të punës”, “Pezullim për shkelje flagrante të sigurisë dhe shëndetit në punë” dënim kryesor “palajmërim”, dënim kryesor “gjobë”, në inspektimet e realizuara në 12 degët rajonale të ISHPSHSH-së rezulton si më poshtë:

#### Inspektime Total (Private+Shteterore)

Deget Rajonale	Gjithsej	Pezullim/Marrëdhënie pune	Pezullim/Siguri në punë	Paralajmërim	Gjobe	Vlere (.000)
<i>Berat</i>	141	2	-	70	-	-
<i>Diber</i>	123	8	1	7	2	312
<i>Durres</i>	280	3	1	40	10	1,646
<i>Elbasan</i>	312	14	1	19	9	2,940
<i>Fier</i>	331	2	-	8	-	-
<i>Gjirokaster</i>	66	-	-	-	-	-
<i>Korce</i>	272	6	-	29	-	-
<i>Kukes</i>	91	15	-	29	-	-
<i>Lezhe</i>	143	7	1	32	2	572
<i>Shkoder</i>	251	6	-	-	6	2,410
<i>Tirane</i>	1,255	63	11	65	10	2,034
<i>Vlore</i>	268	26	-	110	2	150
<b>Total</b>	<b>3,533</b>	<b>152</b>	<b>15</b>	<b>409</b>	<b>41</b>	<b>10,064</b>


#### Masat administrative

Nga të dhënat e inspektimeve rezulton se në më të shumtën e rasteve subjektet e inspektuara janë dënuar me masën “Paralajmërim se sa me masat e tjera ndëshkuese. Kështu në 11.6% të aktiviteteve të inspektuara është marrë masa administrative “paralajmërim”. Në 1.2% të aktiviteteve të inspektuara është marrë masa administrative “gjobë”. Në 4.3 % të aktiviteteve të inspektuara është



marrë masa administrative “pezullim” për shkelje flagrante të legjislacionit për marrëdhënie pune dhe në 0.4% të aktiviteteve të inspektuara është marrë masa administrative “pezullim” për shkelje flagrante të legjislacionit për siguri dhe shëndet në punë.

Nga 617 masat administrative ose 17.5 % e subjekteve të inspektuara, janë mbyllur me masa administrative në periudhën e 3-mujorit të parë 2019, ku kemi:



Këto tregues në degë rajonale rezultojnë:


Deget Rajonale	Subjekte të inspektuara, gjithsej	Total Subjekte me denim administrativ	Subjekte me Paralajmerim	% e subjekteve me Paralajmerim kundrejt Totalit të Inspektimeve	Subjekte me Gjobe	% e Subjekte me Gjobe
Berat	141	72	70	49.6%	-	0%
Diber	123	18	7	5.6%	2	2%
Durres	280	54	40	14.2%	10	4%
Elbasan	312	43	19	6	9	3%
Fier	331	10	8	2.4%	-	0%
Gjirokastr	66		-	0	-	0%
Korce	272	35	29	10.66%	-	0%
Kukes	91	44	29	31.8%	-	0%

Lezhe	143	42	32	22.3%	2	1%
Shkoder	251	12	-	0%	6	2%
Tirane	1,255	149	65	5.17%	10	1%
Vlore	268	138	110	41%	2	1%
<b>Total</b>	<b>3,533</b>	<b>617</b>	<b>409</b>	<b>11.57%</b>	<b>41</b>	<b>1%</b>

Masa administrative “Pezullim”

<i>Degët Rajonale</i>	<b>Subjekte me masa administrativ</b>	<b>Subjekte me Pezullim</b>	<b>% e subjekteve me Pezullim</b>
<i>Berat</i>	72	2	2.7%
<i>Dibër</i>	18	9	50%
<i>Durrës</i>	54	4	7.4%
<i>Elbasan</i>	43	15	34.8%
<i>Fier</i>	10	2	20%
<i>Gjirokaštër</i>	-	-	0%
<i>Korçë</i>	35	6	17.14%
<i>Kukes</i>	44	15	34%
<i>Lezhe</i>	42	8	19.04%
<i>Shkoder</i>	12	6	50%
<i>Tirane</i>	149	74	49.66%
<i>Vlore</i>	138	26	18.84%
<b>Total</b>	<b>617</b>	<b>167</b>	<b>27%</b>

% e subjekteve me Pezullim, kundrejt numrit të masave administrative të mara




Të ndara sipas llojit të aktivitetit Masa urgjente pezullim rezulton të jetë kryer në 167 subjekte, ku numri më i lartë paraqitet në aktivitetin Tregti-Hotel-bar-restorante për marrëdhënie pune, 41 masa urgjente në aktivitet ndërmarrje prodhuese nga të cilat 3 janë për siguri në punë.

Janar Mars 2019	Mase "Pezullim"
Bujqësi, pyje, peshkim	1
Miniera karriera	11
Ndërmarrje Prodhuese	41
Elektricitet, gaz, ujë	2
Tregti, hotel-bar-restorante	74
Ndërtim	6
Transport, magazinim, telekomunikacion	3
Financë, shërbime të sigurimeve	1
Aktivitete te tjera	28
<b>TOTAL</b>	<b>167</b>


Masa administrative "Paralajmërim"

Degët Rajonale	Subjekte me masa administrative	Subjekte me Paralajmërim	% e subjekteve me Paralajmërim
Berat	72	70	97.2%
Dibër	18	7	40%
Durrës	54	40	74%
Elbasan	43	19	44.2%
Fier	10	8	80%
Gjirokastrë	-	-	0%
Korçë	35	29	82.8%
Kukës	44	29	66%
Lezhë	42	32	76.1%
Shkodër	12	0	0%
Tiranë	149	65	43%
Vlorë	138	110	79.7%
<b>Total</b>	<b>617</b>	<b>70</b>	<b>11.34%</b>

% e subjekteve me Paralajmerim, kundrejt numrit të masave administrative të mara




Të ndara sipas llojit të aktivitetit Paralajmërimet janë:




Masa administrative “Gjobë”

Deget Rajonale	Subjekte me masa administrativ	Subjekte me Gjoha	% e subjekteve me Gjoha Kundrejt totalit te Denimeve
Berat	72	-	0%
Diber	18	2	11.1%
Durres	54	10	18.51%
Elbasan	43	9	20.93%
Fier	10	-	0%
Gjirokaster	-	-	0%
Korce	35	-	0%
Kukes	44	-	0%
Lezhe	42	2	4.7%
Shkoder	12	6	50%
Tirane	149	10	6.7%
Vlore	138	2	1.4%
<b>Total</b>	<b>617</b>	<b>41</b>	<b>6.6%</b>

% e subjekteve me Gjoha, kundrejt numrit të masave administrative të mara për muajt Janar, Shkurt dhe Mars 2019






Sipas llojit të aktivitetit të inspektuar rezulton se dënimet administrative të aplikuara gjatë inspektimeve janë:

<i>Janar-Mars 2019</i>	<i>Subjekte të inspektuara Janar-Mars 2019</i>	<i>Subjekte me Mase "Pezullim"</i>	<i>% e Subjekte me Mase "Pezullim"</i>	<i>Subjekte me Paralajmërim</i>	<i>% e subjekteve me Paralajmërim</i>	<i>Subjekte me Gjobë</i>	<i>% e Subjekte me Gjobë</i>
<i>Bujqësi, pyje, peshkim</i>	96	1	1.0%	3	3.1%	0	0%
<i>Miniera karriera</i>	58	11	18.9%	32	55%	3	5.1%
<i>Ndërmarrje Prodhuese</i>	840	41	4.8%	118	14%	14	1.6%
<i>Elektricitet, gaz, ujë</i>	40	2	5%	6	15%	1	2.5%
<i>Tregti, hotel-bar-restorante</i>	1549	74	4.7%	148	9.5%	7	0.45%
<i>Ndërtim</i>	223	6	2.6%	15	6.7%	4	1.7%
<i>Transport, magazinim, telekomunikacion</i>	56	3	5.3%	8	14%	0	0%
<i>Finance, shërbime të sigurimeve</i>	53	1	1.8%	0	0%	0	0%
<i>Aktivitete të tjera</i>	618	28	4.5%	79	12.7%	12	1.9%
<b>TOTAL</b>	<b>3533</b>	<b>167</b>	<b>4.7%</b>	<b>409</b>	<b>11.5%</b>	41	1.1%

### Subjekte me masën Pezullim sipas aktivitetit janë:



### Inspektime për aksident në punë

Sa i takon inspektimeve për aksident në punë rezultojnë se në 30% të rasteve të inspektimit për shkak aksidenti është marrë masa administrative “Paralajmërim”, dhe në 26.% të rasteve është marrë masa administrative “Gjobë”.

Krahasimisht me periudha respektive ne vite kemi:

	Janar-Mars 2019	Janar-Mars 2018	Janar-Mars 2017	Janar-Mars 2016
<b><i>Inspektime për shkak Aksidenti</i></b>	49	36	26	18
<b><i>Punëmarrës të aksidentuar</i></b>	40	45	35	21
<b><i>Punëmarrës të aksidentuar me vdekje</i></b>	13	6	6	0

Sipas degëve rajonale kemi që numri më i madh i inspektimeve për rast aksidenti në punë është kryer në degën rajonale Tiranë dhe Dibër.

Degët Rajonale	Inspektime per aksident							
	Gjithsej	Pezullim/M	Pezullim/S	Paralajmerim	Gjobë	Vlerë (.000)	P/aksidentuar	P/A/vdekje
<b>Berat</b>	1	-	-	-	-	-	-	-
<b>Diber</b>	7	-	-	4	1	260	8	2

<b>Durres</b>	7	1	1	4	3	572	1	1
<b>Elbasan</b>	4	-	1	1	3	980	3	2
<b>Fier</b>	1	-	-	-	-	-	1	1
<b>Gjirokaster</b>	1	-	-	-	-	-	1	1
<b>Korce</b>	3	-	-	1	-	-	3	1
<b>Kukes</b>	2	-	-	2	-	-	2	-
<b>Lezhe</b>	4	-	-	2	-	-	4	1
<b>Shkoder</b>	4	-	-	-	3	1050	4	3
<b>Tirane</b>	15	-	-	1	6	1280	13	1
<b>Vlore</b>	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>Qender</b>	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>Total</b>	<b>49</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>15</b>	<b>16</b>	<b>4142</b>	<b>40</b>	<b>13</b>

Sanksionet e vendosura për rastet e inspektive për shkak aksidenti në punë janë dhe ato me vlerë më të lartë, kjo për shkak të rasteve të mos zbatimit të dispozitave ligjore kryesisht për siguri e shëndet në vendin e punës.

Sipas llojit të aktivitetit ekonomik rastet e aksidenteve në punë rezultojnë:

Janar-Mars 2019	Subjekte të inspektuara për shkak aksidenti në punë	Punëmarrës të Pnm të aksidentuar	Punëmarrës të Pnm të aksidentuar, me vdekje
Bujqësi, pyje, peshkim	-	-	-
Miniera, karriera	7	9	2
Ndërmarrje prodhuese	11	7	2
Elektricitet, gaz, ujë	4	3	2
Tregti, hotel-bar-restorante	2	2	1
Ndërtim	7	5	3
Transport, telekomunikacion	-	-	-
Finance, shërbime të sigurimeve	-	-	-
Aktivitete të tjera	8	14	3
<b>Total</b>	<b>49</b>	<b>40</b>	<b>13</b>



**Inspektime për shkak ankese**

Sa i takon inspektimeve për shkak ankese rezultojnë se në 10.2% të rasteve është marrë dënim kryesor “Gjobë”, ndërkohë në 31.4 % të këtyre inspektimeve është marrë dënim kryesor “paralajmërim”.

<b>Inspektime për ankese Janar Mars 2019</b>						
<b>Deget Rajonale</b>	Inspektime për shkak ankese	Pezullim/shkelje flagrante të marrëdhënie të punës	Pezullim/shkelje flagrante të sigurisë në punë	Masë administrative Paralajmërim	Masë administrative Gjobë	Vlerë (.000)
<b>Berat</b>	4	1	-	4	-	-
<b>Diber</b>	1	-	-	-	-	-
<b>Durres</b>	12	-	-	7	3	880
<b>Elbasan</b>	8	1	-	1	1	260
<b>Fier</b>	2	-	-	-	-	-
<b>Gjirokaster</b>	-	-	-	-	-	-
<b>Korce</b>	2	2	-	-	-	-
<b>Kukes</b>	-	-	-	-	-	-
<b>Lezhe</b>	2	-	-	1	1	312
<b>Shkoder</b>	4	1	-	-	2	880
<b>Tirane</b>	78	10	2	18	4	754
<b>Vlore</b>	14	3	-	9	2	15
<b>Total</b>	<b>127</b>	<b>16</b>	<b>2</b>	<b>40</b>	<b>13</b>	<b>3236</b>

Numri më i madh i ankesave të trajtuara në këtë muaj është realizuar nga Dega Rajonale Tiranë me 78 inspektime për shkak ankese.

Sipas llojit të aktivitetit ekonomik krahasuar dhe me të njëjtën periudhë të një viti më parë, inspektimet e kryera për rast ankese janë:

	<b>Subjekte te inspektuara per shkak ankese 3-mujori i parë 2019</b>	<b>Subjekte te inspektuara per shkak ankese 3-mujori i parë 2018</b>
<i>Bujqësi, pyje ,peshkim</i>	1	1
<i>Miniera, karriera</i>	1	2
<i>Ndërmarrje prodhuese</i>	32	20
<i>Elektricitet, gaz, ujë</i>	2	1

<i>Tregti, hotel-bar-restorante</i>	30	13
<i>Ndërtim</i>	5	7
<i>Transport, telekomunikacion</i>	4	2
<i>Finance, shërbime të sigurimeve</i>	2	1
<i>Aktivite të tjera</i>	50	49
<i>Total</i>	<i>127</i>	<i>96</i>

Nga ankesat e rregjistruara, 52 denoncime të ardhura nga Platforma e Bashkëqeverisjes. Ankesat e adresuara në ISHPSHSH, janë zgjidhur dhe kanë marrë përgjigje në afat, rast pas rasti të gjitha, ndërkohë që 6 janë klasifikuar raste suksesi.

### Punëmarrësit.

Në lidhje me punëmarrësit e evidentuar në punë rezulton se:

50.5% e punëmarrësve të evidentuar janë punëmarrëse femra

1.2 % e punëmarrësve të evidentuar janë punëmarrës që punojnë pa kontrata individuale pune.

28.7% e punëmarrësve të evidentuar janë punëmarrës të siguruar në bazë të pagës minimale.

0.3 % e punëmarrësve të evidentuar janë punëmarrës të huaj.

0.1% e punëmarrësve të evidentuar janë punëmarrës me aftësi të kufizuar.

0.09 % e punëmarrësve të evidentuar janë punëmarrës nën 18 vjeç.

0.38 % e punëmarrësve të evidentuar ishin punëmarrës të pasiguruar (informal)

0.01 % e punëmarrësve të evidentuar ishin të aksidentuar.

Sipas degëve rajonale, kategoritë e të punësuarve evidentuar gjatë inspektimeve, rezultojnë:

### **Aktivite private+shtetërore të inspektuara gjatë muajve Janar-Mars 2019**

Degët Rajonale	Punëmarres	Femra	P/Pakontrata	P/page minimale	Të huaj	Me aftësi të kufizuar	Nën 18 Vjeç	Informal	U siguruan	P/aksidentuar	vdekje
Berat	2,184	848	77	1041	41	-	-	4	4	-	-
Diber	3,605	573	8	249	76	45	-	9	9	8	2
Durrës	10,806	6444	20	1297	4	-	8	6	6	1	1
Elbasan	3,304	1229	42	1508	5	5	1	17	16	3	2
Fier	4,627	1180	4	2006	-	-	0	4	4	1	1
Gjirokastrë	329	137	79	167	-	-	5	-	-	1	1

Korçë	2,094	1129	53	1313	1	-	-	29	29	3	1
Kukës	687	291	157	389	-	-	-	23	22	2	-
Lezhë	3,249	1639	75	1939	25	12	4	16	16	4	1
Shkodër	4,226	2487	54	1928	2	-	3	16	7	4	3
Tiranë	33,379	18466	97	7777	23	8	1	122	121	13	1
Vlorë	5,027	2690	225	1490	14	-	5	51	49	-	-
<b>Total</b>	<b>73,517</b>	<b>37113</b>	<b>891</b>	<b>21104</b>	<b>191</b>	<b>70</b>	<b>27</b>	<b>297</b>	<b>283</b>	<b>40</b>	<b>13</b>
<b>% kundrejt totalit</b>	<b>50.5%</b>	<b>1.2%</b>	<b>28.7%</b>	<b>0.3%</b>	<b>0.1%</b>	<b>0.09%</b>	<b>0.4%</b>	<b>0.4%</b>	<b>0.1%</b>	<b>0.001%</b>	

### Kontrata individuale të punës:

Janë 891 punëmarrës të evidentuar të aktivitetet private të inspektuara ose 1.2% e totalit të punëmarrësve që janë konstatuar gjatë inspektimeve në muajt Janar-Mars 2019, janë evidentuar në punë pa kontrata pune individuale.

Më konkretisht numri i punëmarrësve evidentuar në punë pa kontrata pune individuale në 12 prefekturat e Vendit.

#### Aktivite private të inspektuara


Degët Rajonale	Subjekte	Punëmarrës	Punm pa kontrata	% e Punmarresve pa kontrata
1 Berat	139	1579	77	4.8%
2 Diber	117	2895	8	0.2%
3 Durrës	278	9662	20	0.2%
4 Elbasan	308	3266	42	1.2%
5 Fier	331	4627	4	0%
6 Gjirokastrë	65	292	79	27%
7 Korçë	272	2094	53	2.5%
8 Kukës	90	553	23	4.1%
9 Lezhë	141	2866	75	2.6%
10 Shkodër	250	4192	20	0.4%
11 Tiranë	1253	33277	97	0.2%
12 Vlorë	264	4208	225	5.3%
<b>SHUME</b>	<b>3508</b>	<b>69511</b>	<b>723</b>	<b>1.0%</b>

Duke analizuar të dhënat mbi punëmarrësit e evidentuar pa kontrata pune individuale në llojet e aktiviteteve të kontrolluara rezulton se:

	Lloji i aktivitetit	Subjekte private	Punëmarrës në subjektet private	Nr. punm. Pa kontrata individuale	% e punm. Pa kontrata individuale
1	Bujqësi, pyje, peshkim	96	574	-	-
2	Miniera, karriera	58	3212	16	0.49%
3	Ndërmarrje prodhuese	838	30118	234	0.7%
4	Elektricitet, gaz, ujë	32	676	3	0.4%
5	Tregti, hotel-bar-restorante	1549	11806	294	2.4%
6	Ndërtim	223	4591	52	1.13%
7	Transport, telekomunikacion	56	1048	2	0.19%
8	Finance, shërbime të sigurimeve	53	1313	1	0%
9	Aktivitete të tjera	603	16173	121	7.2%
	<b>TOTAL</b>	<b>3508</b>	<b>69511</b>	<b>723</b>	<b>1%</b>

Sipas llojit të aktivitetit ekonomik numri më i madh i punëmarrësve pa kontrata pune individuale evidentohet llojin e aktivitetit Tregti Hotel Bar Restorante ku zë 2.4% të totalit të punëmarrësve evidentuar në punë, pa kontrata individuale.

Punëmarrësit evidentuar në punë pa kontrata individuale, sipas llojit të aktivitetit



**Punësimi informal (subjekte private të inspektuara):**

Gjatë muajve Janar-Mars 2019, janë evidentuar 297 punëmarrës informal ku gjatë procesit të inspektimit janë siguruar 283 prej tyre, nëpërmjet masës urgjente “pezullim” deri në sigurimin e tyre.

Duke e krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë kemi 246 punëmarrës informal më shumë të konstatuar nga të cilët 95% e tyre janë formalizuar gjatë procesit të inspektimit

Vlen të theksohet se 169 punëmarrës ose 56.9% e punëmarrësve informal të konstatuar janë evidentuar në inspektime të programuara, 76 punëmarrës ose 26.8% e tyre në inspektimet rastësore dhe 47 punëmarrës ose 16.6% në inspektimet për shkak ankese.

Degët rajonale		Aktivitete private të inspektuara					
		Subjekte	Punëmarrës	Informal	U siguruan	Punëmarrës Informal në subjekte pa licence	Subjekte pa licence
<b>1</b>	Berat	139	1579	4	4	-	-
<b>2</b>	Diber	117	2895	9	9	-	-
<b>3</b>	Durres	278	9662	6	6	-	-
<b>4</b>	Elbasan	308	3266	17	16	-	-
<b>5</b>	Fier	331	4627	4	4	-	-
<b>6</b>	Gjirokaster	65	292	-	-	-	-
<b>7</b>	Korce	272	2094	29	29	9	13
<b>8</b>	Kukes	90	553	23	22	17	17
<b>9</b>	Lezhë	141	2866	16	16	-	-
<b>10</b>	Shkodër	250	4192	16	7	-	-
<b>11</b>	Tiranë	1253	33277	122	121	-	-
<b>12</b>	Vlorë	264	4208	51	49	2	2
<b>SHUME</b>		<b>3508</b>	<b>69511</b>	<b>297</b>	<b>283</b>	<b>28</b>	<b>32</b>

Aktivitetet ekonomike ku janë evidentuar punëmarrësit informal:

**Punëmarrësit informal, sipas llojit të aktivitetit**

	<i>Lloji i aktivitetit</i>	<b>Subjekte Private</b>	<b>Punëmarrës në subjektet private</b>	<b>Informal</b>	<b>% Informal, kundrejt punëmarrësve</b>
1	Bujqësi, pyje, peshkim	96	574	2	0.3%
2	Miniera, karriera	58	3212	2	0%
3	Ndërmarrje prodhuese	838	30118	101	0.3%
4	Elektricitet, gaz, ujë	32	676	2	0.2%
5	Tregti, hotel-bar-restorante	1549	11806	112	0.9%
6	Ndërtim	223	4591	17	0.3%
7	Transport, telekomunikacion	56	1048	11	1%
8	Financë, shërbime të sigurimeve	53	1313	1	0%
9	Aktivitete të tjera	603	16173	49	0.3%
	<b>TOTAL</b>	<b>3508</b>	<b>69511</b>	<b>297</b>	<b>0.4%</b>

### Paga

Punësimi me page minimale rezulton evident në 30.3 % të punëmarrësve të evidentuar në punë në aktivitetet private të inspektuara gjatë periudhes Janar-Mars 2019.

<i>Lloji i aktivitetit (Subjekte Private)</i>	<b>Subjekte private</b>	<b>Punëmarrës në subjektet private</b>	<b>Punm. të siguruar mbi pagë minimale</b>	<b>% kundrejt totalit të punm.</b>
<i>Janar-Mars</i>				
Bujqësi, pyje, peshkim	96	574	322	56%
Miniera, karriera	58	3212	241	7.5%
Ndërmarrje prodhuese	838	30118	9442	31%
Elektricitet, gaz, ujë	32	676	62	9%
Tregti, hotel-bar-restorante	1549	11806	5349	45%
Ndërtim	223	4591	1304	28.4%
Transport, telekomunikacion	56	1048	643	61%
Finance, shërbime të sigurimeve	53	1313	160	12.1%
Aktivitete të tjera	603	16173	3577	22%
<b>Total</b>	<b>3508</b>	<b>69511</b>	<b>21100</b>	<b>30.3%</b>

### **DISSHSH në objektivat e saj për vitin 2019, ndër të tjera, ka përcaktuar si objektiva prioritare:**

- Rritjen e kujdesit shoqëror komunitar, në respektim të standarteve të reja për këtë tipologji, por edhe rritja e kapaciteteve të pushtetit vendor për ofrimin e këtyre shërbimeve, në përputhje me nevojat e gjithë komunitetit;
- Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të kujdesit shoqëror, garantimi i respektimit të standarteve të shërbimeve, më qëllim respektimin e të drejtave të përfituesit dhe mbrojtjen e tij nga diskriminimi, dhuna, abuzimi, duke vlerësuar prioritet forcimin e mekanizmave, procedurave të mbrojtjes si edhe rritjen e sensibilitetit të komunitetit ndaj procesit të ankimimit.

Në përputhje me to, për tremujorin Janar-Mars 2019 treguesit janë:

- ✓ **Planifikuar 3** bashki për takime dhe vlerësime të situatës së përgjithshme.  
**Realizuar** takime në **3** bashki dhe vlerësuar situata e përgjithshme e shërbimit në **7 njësi shërbimi**.
- ✓ **Planifikuar** inspektimi në **31** qendra përkujdesi shoqëror.  
**Realizuar** inspektimi i **33** qendrave të përkujdesit shoqëror.
- ✓ **Gjithësej**, janë inspektuar e vlerësuar **40 qendra/njësi** që ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror.

### **Takimet dhe vlerësime në bashki.**

DISSHSH pasi takimeve me bashkitë Shkodër, Vlorë dhe Fier, dhe pasi u njoh me paketat e shërbimit, organizimin, përfituesit, stafin dhe metodikën e menaxhimit të rastit konkludoi se:

- Qendra Komunitare për Familjen e Bashkisë Shkodër, vlerësohet si një model funksional, i cili rekomandohet të aplikohet edhe në bashki të tjera të vendit, në përmbushje të përgjegjësisë që i ngarkon pushtetit vendor, Ligji Nr.121/2016 datë 24.11.2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.
- Bashkia Vlorë dhe ajo Fier në partneritet me organizata ndërkombëtare dhe vendase, për krijimin e qendrave komunitare, specifikisht në Vlorë për Fëmijë me Aftësi Ndryshe, dhe në Fier për Komunitetin Rom, kanë marrë në administrim qendrat përkatëse por nuk kanë krijuar ende qendra komunitare multidisiplinare, me mbulim të gjithë territorit të bashkisë. Ato janë në fazat e hartimit të Planit Social të Zonës, plan i cili do të evidentojë nevojat për shërbime dhe do të propozojë paketën e projekteve me shërbime komunitare. Dy qendrat në fjalë, u

planifikuan dhe u inspektuan si subjekte që ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror, pasi ato ishin edhe më parë të identifikuara si të tilla nga ana e DISSHSH.

### **Inspektimi Standarteve të shërbimeve shoqërore**

Në këtë tremujor janë inspektuar 15 qendra të përkujdesit rezidencial, 18 qendra të përkujdesit ditor, komunitar e shumëdisiplinor. Inspektimet janë kryer në Qarqet Durrës, Vlorë, Elbasan, Bashkia Fier, si edhe për inspektimet e paplanifikuara qendrat i përkasin territorit të Bashkisë Lezhë dhe Qarkut Korçë. Nga këto inspektime konstatohet që përgjithësisht ofrohet shërbime, në përputhje me nevojat e përfituesve, bëhen përpjekje për plotësimin e kërkesave të standarteve.

Në këtë tremujor janë inspektuar paplanifikim 2 qendra që ofrojnë shërbime të kujdesit shoqëror, 1 prej të cilave për trajtim ankese, (Qendra komunitare Malteser Lezhe) dhe 1 qendër në zbatim të procedurave të liçensimit, (Qendra Rezidenciale Kenedi, Maliq, Korçë).

Edhe nga inspektimi i kryer në muajt Janar – Mars 2019 rezultoi mosliçensimi i qendrave publike, pavarësisht nga rastet e rezultuara, (3 nga 6 qendra publike). Nga ana e DISSHSH, u monitorua procesi i liçensimit të Qendrës Rezidenciale Zhvillimit Durrës, me qëllim, evidentimin e praktikës së mirë për të bërë rekomandimet përkatëse edhe për qendrat e tjera publike. Aktualisht, kjo qendër e përfundoi procesin e liçensimit, duke vënë kështu në lëvizje një proces të ngecur.

Ndër konstatimet dhe rekomandimet e bëra përgjatë inspektimeve të tremujorit Janar-Mars 2019, problematika më e ndeshur është mungesa e figurës së mjekut neuropsikiatër në qendrat e zhvillimit për Persona me Aftësi Ndryshe.

Në përfundim u përgatit relacionin përkatës për MSHMSH, SHSSH dhe Bashkitë përkatëse, në të cilat u prezantuan konstatimet dhe rekomandimet e DISSHSH me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimit, si edhe përafrimin e shërbimit me standartet e reja të sapo miratuara për shërbimet e përkujdesit komunitar shumëdisiplinor, Udhëzimi Nr.911, datë 27.12.2018.